



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2018 ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla, në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin e arsimit parauniversitar.
2. Diskutimi i programit të punës së komisionit për muajon tetor 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Fatmir Velaj, Bujar Çela, Almira Xhembulla dhe Besnik Baraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj dhe Adelina Rista.

Të ftuar:

Lindita Nikolla – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Zamira Gjini – drejtore e Përgjithshme për Politikat dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Mirela Bimo – drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar,
Gerti Janaqi – drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit,
Mariglen Mertiri – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Jetlir Gjergji – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit, ministrja Nikolla, që jeni këtu me ne, për të bërë këtë dëgjese lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin e arsimit parauniversitar!

Është kënaqësi që ju kemi këtu, sepse ju kemi ndjekur në të gjitha aktivitetet që keni pasur, me ndryshimet që po ndodhin në sistemin arsimor parauniversitar dhe kemi qenë dëshmitarë të përpjekjeve që keni bërë për disa transformime në paketën ligjore, që i shërbejnë zhvillimit të këtij sistemi në vendin tonë. Përpara se t'ju jap fjalën, dua të pyes zotin Ylli nëse e kemi kuorumin për të filluar.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, ne jemi 10 anëtarë dhe mund të fillojmë mbledhjen. Por më vjen keq, sepse në kërkesën për thirrjen e ministres në këtë komision kemi qenë bashkë me opozitën, ndërsa tani ministrja vjen dhe opozita nuk vjen. Megjithatë, ne jemi të detyruar të vazhdojmë punën tonë.

Bujar Çela – Mirëdita të gjithëve!

Përsëritës stafin e Ministrisë së Arsimit!

Puna e nisur në këtë vit shkollor duket në të gjitha rrethet, qarqet dhe shkollat e vendit. Është një vit entuziast, i cili do të realizojë programin e qeverisë për arsimin. Meqenëse opozita, që ka kërkuar ministren here pas here dhe është bërë objekt shërresh, nuk ka ardhur, unë i propozoj komisionit nëse është e mundur që në fillim të dëgjojmë stafin për të gjitha problematikat dhe pastaj ministren.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Edhe unë bashkohem me ju dhe ndjej keqardhje përse nuk e kemi opozitën këtu. Ne i kemi dhënë edhe kohën e mjaftueshme që të marrë një vendim për të dëgjuar këtë dëgjese që kishte të bënte me zhvillimin e arsimit parauniversitar në vend dhe me fillimin e vitit të ri shkollor, ndërkohë që në të trija herët që kemi bërë kërkesë, kemi shtyrë afatet kohore vetëm për të pasur një përgjigje nga përfaqësuesit e tyre. Megjithatë, kjo është punë e tyre dhe nuk futemi dot të lëvizja parlamentare që ata bëjnë.

Me vjen keq, Bujar, të të them, por mendoj se është më mirë të dëgjojmë ministren në fillim, sepse ndryshimet që kanë ndodhur së fundi në këtë pjesë të sistemit arsimor, kanë qenë të shumta. Ju vetë keni qenë dëshmitar i ndryshimeve ligjore që kemi miratuar, prandaj mendoj që duhet të fillojmë me ministren dhe pastaj, nëse kemi pyetje, specialistët mund të përgjigjen.

Fjalën e ka zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Për respekt të procedurave, ne kemi ftuar ministren dhe ajo ka ardhur me stafin. Nëse e shikon të arsyeshme, në momente të caktuara për t'u konsultuar, mund të konsultohet, por ne duam të dëgjojmë zërin e ministres saj për çështjen që jemi mbledhur sot.

Milva Ekonomi – Zonja Nikolla, mezi po presim të të dëgjojmë dhe të na bëni një shpjegim të situatës.

Lindita Nikolla – Faleminderit për ftesën!

Në emër të gjithë Ministrisë së Arsimit, por besoj jo vetëm, por edhe të të gjithë skuadrës së arsimit, dua të shpreh mirënjohjen për të gjithë gatishmërinë, jo vetëm për të dëgjuar raportimet e ministres së Arsimit për detyrat dhe përgjegjësitë që ajo ka, por mbi të gjitha për të gjithë monitorimin, kritikën e vyer dhe ndjekjen që i bëni të gjithë sistemit arsimor dhe reformave të ndërmarra në sistemin arsimor!

Më lejoni t'ju them që viti i ri shkollor ka filluar me një sërë risish dhe dua të ndalem në disa prej tyre.

Janë 400 mijë nxënës që këtë vit kanë filluar të gjithë punën me kurrikulën e re, e cila i dha fund mbingarkesës në sistemin tonë arsimor dhe përafroi sistemin tonë arsimor me standardet më të mira europiane, por edhe më gjerë.

Implementimi i kurrikulës mungon vetëm në klasën e pestë, e cila këtë vit po pilotohet dhe vitin e ardhshëm edhe klasa e pestë do të përfshihet në sistemin e kurrikulës së re bazuar në kompetenca.

Ju bëj me dije që të gjithë mësuesit që janë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe që zbatojnë kurrikulën e re, janë të trajnuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, me një kalendar dhe një tematikë specifike, në mënyrë që mësuesit të përmbushin performancën dhe standardet e duhura që kërkon kjo qasje dhe ky vizion i ri, në të cilën është futur sistemi ynë arsimor parauniversitar.

Rreth 400 mijë nxënës në sistemin e arsimit parauniversitar, që përdorin kurrikulën e re, sot punojnë me tekste të reja të standartve bashkohore të lehtësuara, të larguar nga ajo që ekspertët e huaj e quanin një standard të frikshëm i mbingarkesës në tekstet shkollore, duke i dhënë fund situatës, që ekspertët e huaj në vitin 2011 linin detyra në tryezën e ministrit të Arsimit, për të ndërhyrë me emergjencë dhe për të rishikuar të gjithë metodologjinë në të cilën ndërtoheshin tekstet, pasi ato nuk kishin më asgjë të përbashkët, jo vetëm me moshën dhe zhvillimin psikologjik, por edhe me atë që metodologjia bashkohore njihte si standarde të reja të nxënies.

Janë rreth 400 mijë nxënës që punojnë me tekste të reja të Oxford-it, Cambridge-it dhe Pirson-it. Por nga ana tjetër, më lejoni t'ju them, që edhe tekstet që botohen nga autorë shqiptarë janë të një standardi të ri, shumë cilësorë dhe kënaqin pritshmërinë e kurrikulës dhe qasjes së re, në të cilën është përfshirë shkolla shqiptare.

Është viti i parë i implementimit të teksteve falas në sistemin tonë arsimor, rreth 190 mijë nxënës përfituan tekste falas nga klasa e parë deri në klasën e katërt, përfshirë këtu edhe 16 kategoritë në të gjithë sistemin tonë arsimor. Unë kam bërë edhe tabelën e shifrave se sa nga këta 190 mijë nxënës kanë përfituar: 125 mijë e 844 nxënës janë nga klasa e parë deri në klasën e katërt, 47 mijë e 648 nxënës janë nga shtresat në nevojë që vijojnë arsimin parauniversitar, nga klasa e pestë në atë të nëntë edhe 16 356 nxënës që vijnë po nga shtresat në nevojë, nga 16 kategoritë që janë përcaktuar për të përfituar tekste falas që i përkasin gjimnazit. Pra në total janë 189 850 nxënës që kanë përfituar tekste falas, me një buxhet të alokuar nga buxheti i Ministrisë së Arsimit, të qeverisë shqiptare, prej 610 milionë lekësh.

Pra, është një moment cilësor dhe një standard i ri i përkujdesjes për të pasur gjithëpërfshirje dhe mundësi të barabarta në arsim, por edhe një tregues që reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare po japin fryte. Nga taksat e shqiptarëve po mundësohen shërbime të reja dhe cilësore, duke u kthyer mbrapsht edhe në formën e këtij shërbimi të ri, pra të përfitimit të teksteve falas për fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e katërt. Me futjen e kurrikulës së re në klasën e pestë, mot do të mundësohen edhe tekstet falas për fëmijët që studiojnë në klasën e pestë.

Një risi tjetër e këtij viti shkollor ka të bëjë edhe me një standard të ri në kualifikimin e mësuesve, bazuar në nevojat e tyre. Ashtu sikurse u angazhuam, ne mundësuar kualifikimin apo trajnimin falas, përmes Institutit të Zhvillimit të Arsimit, të rreth 20 mijë mësuesve. Ky kualifikim nuk u bazua në tematika apo në fushat e përcaktuara nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, por pikërisht në ato fusha ku mësuesit, në bazë të testimit, rezultonin të ishin joperformant, duke mundësuar nxjerrjen nga vështirësia të mësuesve në fusha të caktuara, por dhe duke adresuar edhe një sistem të ri të kualifikimit, shumë eficient dhe transparent, bazuar në nevojat reale. Ne kemi mundësuar shumë konferenca, takime, por edhe ekspertizë. Janë të certifikuar dhe të akredituar institucione ku peshën më të madhe e kanë institucionet e arsimit të lartë publik, në mënyrë që të kemi edhe lidhjen e munguar mes fakulteteve, ku formohen mësues dhe nevojës që këto fakultete të reformojnë kurrikulën e tyre, përshtatur me nevojat dhe situatën e re që reforma e arsimit parauniversitar sjell në këtë moment, pra në atë që është kualifikimi i të gjithë mësuesve që janë në sistem.

Është një vit shkollor që fillon me 26 shkolla të reja, të rikonstruara për afro 10 mijë nxënës, që do të thotë një standard i ri i kushteve fizike për të mundësuar atë që është prioriteti: cilësinë e re në sistemin tonë arsimor.

Një moment i ri, që duhet theksuar, ka të bëjë edhe me startimin e klasave sportive. Rikthehen klasat sportive në sistemin tonë arsimor, duke pilotuar disa lloje sportesh, sigurisht të vendosur që këtë ta shtrimë, në vitet e ardhshme, në të gjithë sistemin tonë arsimor.

Dua të ndaj edhe diçka tjetër, që ka qenë kryefjala e përpjekjes sonë këtë vit.

Unë do të doja të falënderoja të gjithë deputetët, por edhe kryetarët e bashkive që u bënë pjesë mbështetëse e përpjekjes sonë në procesin e shpërndarjes së teksteve falas! Duhet thënë se u dhamë fund kategorive që përfitonin tekste falas dhe një metode të vjetër, që shpeshherë rezultonte në lodhje të prindërve. Në fillim prindërve u kërkohej të paguanin për tekstet dhe më pas u rimbursohej shumica e paguar, kurse këtë vit këtë barrë ne ua kaluam shkollave dhe institucioneve arsimore. Prindërve, të cilët përfitonin nga kategoritë e tjera për tekste falas, nuk iu është dashur më të paguajnë dhe më pas të rimbursoheshin, por i kanë përfituar tekste falas, ashtu sikurse thotë edhe vendimi i Këshillit të Ministrave.

Tjetër gjë që dua të ndaj ka të bëjë me përqendrimin e shkollave që kanë klasa kolektive. Besoj jo vetëm unë, por edhe mësuesit, nxënësit dhe komunitetet, janë ndjerë keq teksa shikonim deputetë të nderuar të këtij komisioni, që flisnin për shkolla të mbyllura dhe shfaqeshin në dyert e shkollave në fshatra dhe në zona të caktuara të vendit, duke krijuar një lloj stuhie në gotë për të treguar se si kjo qeveri apo se si ministria po lë jashtë dyerve të shkollave nxënës dhe nuk po mundëson punësimin e mësuesve. Besoj se populli dhe komuniteti rreth këtyre shkollave janë shumë të qartë, por më lejoni t'ju raportoj edhe një herë se kjo është një përpjekje, të cilën ne duhet ta vazhdojmë edhe në ditët në vijim, edhe në vitet në vijim, për t'u dhënë fund, në mënyrën më maksimale të mundshme, klasave kolektive, që kanë qenë dhe janë pjesë e sistemit tonë arsimor. Këto klasa kolektive nuk u shfaqën këta 4 vjet, nuk u shfaqën këtë vit, por ajo që ka ndryshuar këtë vit është fakti se Ministra e Arsimit dhe e gjithë hierarkia e arsimit nuk mbyll gojën, sytë dhe veshët për të mos dëftuar se çfarë ndodh pas dyerve të këtyre klasave kolektive. Patjetër ne jo vetëm që flasim dhe themi se janë 33 mijë nxënës, të cilët studiojnë në këto klasa kolektive, por kemi marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë për të mundësuar një histori të re edukimi dhe formimi të nxënësve që kanë fatin të mësojnë në zona të thella dhe që kanë fatin të mësojnë në klasa kolektive. Po ashtu, dua t'ju them se ne kemi bërë një studim shterues dhe para një viti kemi nisur testin e lexim- shkrimit për të gjithë nxënësit që mësojnë në klasat kolektive, duke i parë realisht emër për emër se si është standardi i tyre në lexim-shkrim. Më pas, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, kemi

ndërtuar një program të detajuar për lexim-shkrimin dhe kemi bërë një program fillestar me 100 orë mësimi në 20 javë, duke u fokusuar te rreth 6 mijë nxënës, të cilët nuk kanë standardin e duhur qoftë në lexim, qoftë në shkrim. Gjithashtu, kemi realizuar 6 orë mësimore në 12 javë, pasi trajnuam 1289 mësues, të cilët japin mësim në klasat kolektive.

Ky standard nuk mjaftonte dhe neve na duhej ta adresonim situatën, sepse në një klasë mund të mësonin nxënës të moshave të ndryshme dhe një klasë tjetër mund të kishte 3, 10 apo 15 nxënës. Këto janë klasat apo shkollat, siç rreken t'i quajnë deputetët e opozitës, të cilat ne jo vetëm i kemi mbyllur, por jemi të vendosur që këtë proces ta thellojmë edhe më tej, për t'u dhënë fund në maksimum klasave kolektive në vend. Për këtë arsye është folur edhe për 150 shkolla të mbyllura.

Ne kishim 228 shkolla vartëse, të cilat kishin klasa kolektive edhe me 5 nxënës. Pra, le t'i quajmë shkolla, por këtu bëhet fjalë për mbylljen e 348 klasave kolektive, të cilat ne i kemi mbyllur dhe nuk funksionojnë më si të tilla. Ne u kemi mundësuar 2 829 nxënësve që t'i çojmë në shkolla të afërta, duke garantuar procesin e transportit, duke mundësuar që këta nxënës të mësojnë në klasa të një niveli normal. Mendoj se kjo është detyra jonë edhe në vijim, për t'u dhënë mundësinë këtyre nxënësve që jo vetëm të marrin cilësinë e merituar të dijes, por, nga ana tjetër, edhe në aspektin social, t'u japim mundësinë këtyre nxënësve për të pasur shokë klase apo për shokë shkolle, sepse me klasa me 3 nxënës ishte e pamundur që ata të kishin shokë klase apo shokë shkolle. Ndaj, edhe një herë dua t'ju them se ka qenë një proces tejet i vështirë, një proces që ka dashur vullnet dhe patjetër vendosmëri, por i mbështetur në studime mirëfilli, që ekipet kanë bërë në 12 qarqet e vendit, duke fotografuar situatën reale në çdo klasë, duke parë mundësinë se si mund t'i transportojmë nxënësit e këtyre klasave, si është situata e rrugëve, sa duhet të lëvizin, si mund të mbështesim transportin e kështu me radhë. Nga ana tjetër, më lejoni t'ju them se ky proces ka ndihmuar edhe në shkollat pritëse, që ndoshta edhe ato mund të kenë pasur klasa kolektive dhe ardhja e këtyre nxënësve ka mundësuar që në ato shkolla të përmirësohet sistemi i klasave kolektive. Kjo është njëra anë e medaljes, sepse ne ishim përgatitur për një situatë shumë më të vështirë. Shpeshherë pushteti vendor dhe politika bënë të kundërtën e asaj që duhej të bënin, të ishin në anën e nxënësve dhe prindërve për të mundësuar një sistem të mirë arsimor. Ata u përpoqën që këtë nismë ta shfaqnin në publik si një dashakeqësi të qeverisë, duke mbyllur këto klasa kolektive.

Më lejoni t'ju them se në një konferencë me përfaqësues të nivelit të lartë të UNICEF-it ky qëndrim i qeverisë shqiptare, jo vetëm është përshëndetur, por theksuan që, nëse ne flasim për nevojën dhe standardet e një arsimi gjithëpërfshirës dhe fokusohemi vetëm te nxënësit me aftësi ndryshe, te nxënësit me nevoja të veçanta, te nxënësit që vijnë nga familje të varfra, me

probleme sociale është e paimagjinueshme që ne të anashkalojmë këtë grup të madh, që janë pikërisht fëmijët që mësojnë në klasa kolektive. Për ta standardi gjithëpërfshirës duhet kthyer në një standard debati politik apo në një standard, ku të gjitha forcat me vullnet bashkohen për të adresuar në mënyrë të plotë këtë moment. Ndaj, ky është vetëm hapi i parë dhe ne në vijim jemi duke u dakordësuar me komunitetin e prindërve dhe me pushtetin vendor për t'u thelluar më tej në këtë proces.

Nga ana tjetër, ne jemi duke punuar me standarde të reja edhe me mësuesit që do të vijojnë të punojnë në klasa kolektive, me të cilët jo vetëm kemi krijuar rrjetin profesional të tyre, por janë në fokusin e trajnimit. Madje, për këta mësues është vënë në dispozicion një manual, referuar përvojave më të mira ndërkombëtare të punës me klasa kolektive, sepse klasat kolektive nuk janë vetëm fenomen shqiptar. Unë besoj se edhe në ato klasa kolektive, ku ne nuk e adresojmë sivjet përqendrimin e tyre, do të kemi një standard të ri. Po ashtu, unë do të informoj dhe do të bëj publik edhe nivelin e dijeve të të gjithë nxënësve që mësojnë në këto klasa kolektive, për të parë progresin e tyre krahasuar me një vit më parë. Kjo gjë është shumë e rëndësishme për të adresuar ndihmën e duhur drejt këtyre nxënësve.

Sikurse ne premtuam, të gjithë mësuesit që preken nga fakti i mbylljes së klasave kolektive, nxënësit e të cilëve i kemi përqendruar në shkollat më të afërta, nuk do të dalin nga sistemi. Kjo është një e vërtetë që u mundësua ligjërisht edhe nëpërmjet udhëzimit nr. 30, dhe ka mundësuar jo vetëm uljen e normës së mësuesve të disa profileve, uljen e normës mësimore të mësuesve, që drejtojnë rrjetet profesionale, uljen e numrit të nxënësve në klasa, por ka mundësuar edhe rifutjen apo mosdaljen nga sistemi të mësuesve që kanë punuar për vite e vite me radhë, në kushte të vështira, në këto 228 shkolla/klasa kolektive që u mbyllën.

Një tjetër risi e këtij viti shkollor ka qenë fakti se ne u angazhuam, me shumë përgjegjësi, që të dyfishonim numrin e mësuesve ndihmës. Ne e tejkaluam atë, ku nga 640 që ishte angazhimi ynë, sot në sistem janë 700 mësues ndihmës, të cilët ofrojnë një shërbim më të mirë për nxënësit me aftësi ndryshe. Ky është në shërbim i ri dhe unë nuk po e përsëris këtë për të thënë se sa ndryshe po punojmë në fakt, sepse nuk është ky qëllimi ynë, por dua të them se nga shërbimi i munguar ne sot kemi 700 mësues ndihmës.

Së pari, prindërve dhe komunitetit të mësuesve ky shërbim i ri që u adresohet, patjetër që ka edhe problematikat e veta, sepse Shqipërisë i mungon arsimi i pedagogjisë speciale, kualifikimi dhe trajnimi cilësor për këtë grup mësuesish, që ofrojnë shërbimin për nxënësit me aftësi të veçanta, por ne jemi duke bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare, si UNICEF-i, si dhe organizata të tjera, të cilat po mundësojnë trajnimin dhe kualifikimin e këtyre mësuesve,

sa kohë që fakultetet e edukimit do të mundësojnë hedhjen në sistem të mësuesve që kanë diplomën e pedagogjisë speciale.

Gjithashtu, është për t'u përshëndetur se në këtë vit shkollor, i cili po fillon, do të ketë edhe një mundësi të re për drejtuesit e shkollave. Është në përgjegjësinë time për t'ju adresuar gjithçka që lidhet me cilësinë e drejtimit të shkollave. Ne nuk ia kemi dalë ende që në krye të shkollave të kemi drejtuesit më të aftë, sigurisht jo kudo, sepse kemi edhe drejtues të talentuar, të cilët mundësojnë një cilësi të re në krye të shkollave, por jam duke folur për atë pjesë ku ende vendos përzgjedhja politike apo nepotike për të qenë drejtues i shkollave, prandaj edhe për këtë proces po fillojmë standardin e ri.

Do të doja t'u përgjigjesha të gjithë atyre ekspertëve që thonë se janë ekspertë të arsimit, por, në fakt, janë mirëfilli pjesë e opozitës dhe në kohën që kanë qenë punonjës të Ministrisë së Arsimit, janë dalluar për bëmat e tyre, si kopja e maturës shtetërore apo për një sërë historish të tjera. Ata mendojnë se shkolla e drejtorëve është një atavizëm, diçka që nuk i duhet sistemit, duke thënë se u kundërvihet programeve të masterit në universitetet tona, gjë që është sqaruar dhe risqaruar. Shkolla e drejtorëve nuk është një shkollë që zëvendëson diplomën master në universitetet publike, por është një shkollë që mundëson trajnimin në vijim të atyre që aspirojnë apo që janë drejtues shkollash dhe sigurojnë publikun për cilësinë e këtij formimi, sepse në fund kanë një proces certifikimi. Pra, kur thuhet që në fund është një proces certifikimi, kjo nuk nënkupton atë që thoshte një drejtues i nderuar i sindikatës së arsimit, që gjithë drejtorët që janë të paaftë apo janë aty për shkaqe të tjera dhe jo të meritës së tyre, do të certifikohen, por është e kundërta. Pikërisht ky proces i fortë i provimit dhe i certifikimit do t'i lërë jashtë, sepse paaftësia nuk mund të certifikohet nga një institucion, i cili nuk është një institucion që krijohet nga Ministria e Arsimit me ekspertët e vet, por është një institucion që krijohet në partneritet me Fondin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim me modelet më të mira që ka bota dhe ekspertët e huaj dhe vendas më cilësorë që bota njih, por edhe vendi ynë i ka këta ekspertë, në mënyrë që ne t'i japim fund dhe ta sigurojmë publikun për një sistem të ri në menaxhimin e shkollave. Është e pamundur që ne të ndryshojmë 37 mijë mësues që janë në sistem, duke kualifikuar dhe rritur standardin e tyre të cilësisë dhe të performimit në klasë. Në kohën e duhur dhe patjetër që ne do ta kapim këtë kohë nëse investojmë në rreth 2 400 drejtues shkollash, në mënyrë që secili prej tyre të kthehet në pikën e vet të rëndësës për të përmirësuar punën me mësuesit dhe gjithçka që jeta shkollore rrek me fokus kryesor arritjen e nxënësve.

Dua të ritheksoj që ka një korrelacion të fortë midis eficiencës dhe performancës së drejtuesit të shkollës me arritjet e nxënësve. Ky është pikërisht thelbi që shkolla e drejtorëve,

të cilën ne po e ndërtojmë me modelet më të mira, do të bëjë të mundur që arritjet dhe suksesi i nxënësve të jenë të një standardi të ri.

Këto ishin ato që doja të veçoja në fjalën time, për t'ju informuar për proceset e fillimit të vitit të ri shkollor, ashtu sikurse nuk dua t'ju them që ka qenë një nisje dhe çdo gjë ka qenë perfekte. Ne ende kemi shkolla që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente në rikonstruksionin e tyre, kemi ende komunikime të munguara për nga niveli i përgjegjësisë me bashkitë në vend, të cilat duhet të përgatisin në kohën e duhur dhe në cilësinë e duhur mjediset shkollore, në mënyrë që ato të jenë gati për fillimin e vitit të ri shkollor. Jo kudo kjo gjë ka vijuar në nivelin dhe standardin e duhur të përgjegjësisë. Nga ana tjetër, pa dyshim ka qenë edhe një ndërveprim me institucionet e tjera, siç është Ministria e Shëndetësisë, e cila ka bërë një inspektim të higjienës në të gjitha institucionet tona arsimore parauniversitare, duke lënë detyra konkrete si për shkollat, ashtu edhe për pushtetin vendor.

Ka pasur problematika që media i ka raportuar, siç ka qenë ajo e një shkolle 9-vjeçare në Elbasan, në Mëngël. Në fakt, nuk dua të bëj shumë politikë, por ka qenë vërtet befasuese të shihje se si nxënësit shtyheshin nga deputetët e opozitës për të thyer derën e shkollës, një simbolikë e shëmtuar, ku vetëm për cilësinë e edukimit dhe për nivelin e sjelljes dhe të shprehisë qytetare nuk ofrohet dhe, nga ana tjetër, një dëshirë për ta sjellë këtë moment në një shkollë të vendit, sikur është një situatë në të cilën është përfshirë i gjithë sistemi arsimor. Besoj, sikurse është raportuar edhe në media, bëhet fjalë për një shkollë 9-vjeçare, për nxënësit e së cilës Drejtoria Arsimore kishte ofruar të gjithë transportin. Në qoftë se e shihni me një sy të vëmendshëm atë video, autobusët e bashkisë dhe të Drejtorisë Arsimore prisnin, ndërsa deputeti pengonte nxënësit dhe prindërit e tyre për të vijuar mësimin normalisht, duke kërkuar futjen me forcë në shkollë, ndërkohë që institucionet e verifikimit të sigurisë shpreheshin se ishte një shkollë e pasigurt për shkak të tërmetit.

Kanë filluar punimet për rikonstruksionin e pjesshëm të shkollës dhe mësimi vijon normalisht, ashtu sikurse duhej të kishte ndodhur në shkollën “Abdyl Faralloi” në Elbasan. Kemi pasur një situatë edhe në Shkodër për nxënësit nga fshati Sheldi, gjithsej 47 nxënës, 12 të shkollës vartëse Sheldi dhe 35 nxënës të shkollës Ragam. Në bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër ne i qendëruam, por prindërit kërkonin që mësimi të ishte në klasa të ndara pranë shkollës së ndërtuar nga motrat Salvatoriane në fshatin e tyre. Kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm dhe u dakordësua që nxënësit ta zhvillonin mësimin në fshatin Sheldi, por me klasa të bashkuara.

Gjithashtu, kemi pasur një problem në Durrës me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Borak” të Bashkisë Shijak, të cilët 4 ditët e para nuk e kanë zhvilluar procesin mësimor në

Maminas, për shkak se shkolla ndodhej në kushte të vështira, por në shenjë proteste, duke kërkuar rikonstruksionin e shkollës së tyre, kanë protestuar duke zgjuar gjithë vëmendjen, së pari, të pushtetit vendor për të përgatitur projektin e investimit dhe, më pas, për ta paraqitur atë pranë Ministrisë së Arsimit.

Këto janë momentet që do të doja të veçoja, por sigurisht ka pasur edhe problematika të caktuara aty-këtu, por që janë ndjekur me përgjegjësi ditë pas dite dhe ndoshta orë pas ore të çdo dite, për ta përmirësuar situatën dhe për të bërë të mundur që edhe një problematikë sado e vogël qoftë, të mos cenojë atë që është shumë e shenjtë dhe e rëndësishme, procesin mësimor edukativ.

Jam e gatshme t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve që ju mund të keni.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Ju lutem, ta bëjmë me radhë! I pari e ka kërkuar fjalën Bujari dhe, më pas, Fadili, Ismeti, Musai, Vilma, Almira.

Bujar Çela – Përsëritje!

Unë kam qenë dhe jam i bindur që stafi i Ministrisë së Arsimit është treguar gjithmonë i përgjegjshëm dhe këmbëngulës për të zbatuar dhe për të bërë të mundur realizimin e programit të qeverisë për arsimin. Dua t'ju përsëritës, ndryshe nga ata që ju i quajtet “të nderuar”, sepse vetëm të nderuar nuk janë, por janë deputetë që prodhojnë babale, pengojnë mosfunksionimin e reformës në drejtësi, prodhojnë ngërçin e mosintegritetit të Shqipërisë në Europë. Ata e kanë treguar sjelljen e tyre me të gjithë, kudo; ata vetëm për arsimin nuk flasin, por flasin për bëmat në arsim gjatë qeverisjes së tyre.

Jam plotësisht dakord me të gjitha shpjegimet që ju na dhatë, por kisha një pyetje shumë të thjeshtë, që lidhet me atë që është trashëguar prej shumë vitesh, pra që ne kemi mësues të dobët, sepse nxënësit kanë qenë të dobët dhe një student i dobët rezulton që në 100% të rasteve të përfundojë një mësues i dobët.

Unë kam bërë dikur një propozim për parjen e aseteve të trashëguara, që janë të moshës sonë, që në 5 vjetët e fundit të punës, si për femrat, ashtu edhe për meshkujt, të reduktohet ngarkesa mësimore qoftë edhe 50%. Duke ulur normën e ngarkesës, me përvojën e tyre të gjatë në mësimdhënie, të ritrajnojnë këta mësues që kanë nxjerrë nxënës të dobët apo mësues të dobët.

E dyta që shihet në këtë proces është transporti mësues-nxënës, i cili shpesh ka qenë objekt debati dhe ne nuk jemi shumë të qartë se kush e paguan. Unë kam bindjen se transportin e mësuesve dhe të nxënësve e paguan qeveria; dikur kanë qenë linja paralele edhe për nxënësit,

por tani me mbylljen e klasave kolektive, më thonë që transporti i mësuesve dhe nxënësve përdor ende tarifën e vitit 1994. Nuk jam shumë i qartë, por ka disa vjet që transporti i tyre bëhet në mënyrë private. Mësuesve iu kalohen në pagë shpenzimet për transportin, sepse e zgjidhin transportin në mënyrë individuale. Unë mendoj se kjo është e padrejtë. Mësuesit, nxënësit dhe drejtorët, të cilët jo rrallë nuk janë në punë në orarin e punës, duhet të udhëtojnë me të njëjtin mjet, në mënyrë që të jenë të gjithë si kolektiv.

Këshilloj që transporti i tyre të kthehet me tenderimin e dikurshëm, ku të ketë transportues të përgjithshëm dhe me orare që i shërbejnë procesit mësimor. Shkolla është vendi ku dija fitohet me mund dhe djersë.

Milva Ekonomi -Faleminderit!

Unë mendoj se është më mirë që të grumbullojmë pyetjet dhe pastaj të jepni përgjigjet.

Fadil Nasufi - Falënderoj zonjën Nikolla dhe stafin e Ministrisë së Arsimit për hapat konkretë që janë bërë në këta 5 vjet të qeverisjes sonë në reformën e arsimit, që tashmë është një reformë shumë e konsoliduar, e cila nxori arsimin nga e gjithë vorbulla ku e kishte davaritur tranzicioni. Është një nga sfidat më kryesore që ne kemi dhe që po e përballim me shumë përkushtim, me shumë vëmendje nga kryeministri dhe të gjithë njerëzit e ditur të këtij vendi që janë shumë të fokusuar në mbështetjen e kësaj reforme të vështirë. Ministrja bëri një prezantim për masat e marra në lidhje me fillimin e vitit të ri në arsimin parauniversitar dhe më vjen mirë që sot u ndie e qetë, se në këtë komision e kemi masakruar, e kam fjalën për opozitën dhe qëndrimin e saj, me përdorimin e një fjalore denigruese, përcjellje diskutimesh të agravuara, sepse edhe ne jemi një lloj shkolle për atë që transmetojmë te njerëzit që na dëgjojnë. Kur njerëzit dëgjojnë konflikt, sharje, ofendime, përbaltje, akuza, çfarë shembulli do të japim ne të fëmijët që shkelin për herë të parë në shkollë dhe mbarojnë arsimin parauniversitar?! Fatmirësisht ky komision ka dy ministre, të Arsimit dhe Kulturës, që janë të dyja zonja të vërteta, por fatkeqësisht iu është krijuar një ambient terrori nga opozita. Këto zonja e kanë përballuar me dinjitet, me urtësi dhe kanë shërbyer si model që duhet të marrin qytetarët shqiptarë. Kështu që ne duhet të jemi kritikë për ato gjërat që janë kritike, për sfidat reale që kemi, por edhe në raport me opozitën që është shumë mbrapa në reformimin edhe të etikës së saj parlamentare.

Unë nuk do të zgjatem shumë, sepse i njohim problematikat e arsimit. Viti i ri shkollor ka filluar më mirë se çdo vit tjetër, me ato risi që edhe ministrja i përmendi.

Falënderoj qeverinë që për këtë vit shpërndau librat falas, për rreth 190 mijë nxënës në të gjithë Shqipërinë nga klasa e I-IV!

Dua të mbështes dhe falënderoj ato bashki, të cilat e mbështetën nismën e qeverisë, si, për shembull, Bashkia e Fierit që ndau librat falas për klasën V. Pra, kur të gjithë faktorët e pushtetit janë në akord me mbështetjen e qeverisë dhe reformat e qeverisë, reformat ecin më shpejt dhe produktiviteti i përfitueshmërisë vjen po kështu më shpejt.

Dua të falënderoj donatorët që i janë bashkuar reformës dhe mbështetjes së arsimit!

Unë këtë e them nga faktet. Bashkë ishim në përfundimin e shkollës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore, që e mbështeti projekti i Fondit Shqiptaro-Amerikan. Gjithashtu, kompanitë e TAP-it në rrethin e Beratit kanë financuar për rikonstruksion të plotë të shkollave, siç është shkolla e Uznovës në Berat, shkolla “1 Maji”, kopshti i Dushnikut, shkolla e Veterikut, shkolla e Kutallisë. Pra, janë 5-6 institucione që po ndërtohen me standardet më bashkëkohore dhe iu bashkohen investimeve që ka bërë qeveria shqiptare për shkollën e Starovës, për shkollën “Zylyftar Veleshnja”, “Kareman Ylli” dhe për shkollat në Kuçovë. Nga viti në vit qeveria po e rrit trendin e investimeve për shkollat.

Pa dyshim që sfidat janë të mëdha për shkak të diferencave dhe pabarazisë, që është krijuar në zonat e thella, të atyre problemeve që lidhen me klasat kolektive. Në Berat kemi 239 klasa kolektive; u mbyllën 10 në drejtorinë e Beratit, për të cilat patën kundërshti, por kur menaxhohen në interes të prindit dhe nxënësit, kur mësimi në klasat teke dhe shkollat e përqendruara rrit cilësinë e dijes për fëmijët, atëherë ndërgjegjësohen.

Ka probleme me çështjet e transporteve, realisht janë miratuar rreth 100 linja në qarkun e Beratit, por vijnë fazat e tenderimeve, që vonojnë procedurat e kryerjes së shërbimit në kohën e duhur, kur fillon viti mësimor, si edhe mënyra e shpërndarjes së tarifës që kompensohet ndonjëherë kesh. Në Berat rreth 550 mësues dhe 1935 nxënës i marrin në kesh shpenzimet e shërbimit të transportit. Unë jam kundër dhënies kesh të transportit, sepse ndoshta ndikon në zonat e thella, si një lloj asistence që e marrin në xhep, por nuk ia japin fëmijëve për të shkuar në shkollë dhe nxitet në njëfarë mase analfabetizmi funksional, për shkak se ka edhe prindër që janë jo të përkushtuar për të vazhduar fëmijët shkollën.

Gjatë shpërndarjes falas të librave shkollorë shumë kolektiva mësuesish ngritën disa probleme. Pohojnë pozitivitetin e të gjithë reformave, për kurrikulën, pajisjen me laboratorë, sistemin e 3 lëndëve në 6 orë, e të tjera, por ka edhe probleme që lidhen me ngarkesën e orëve të mësimi. Për shembull, janë ngritur problemet që mësuesit që janë me moshë gati në kufirin e pensionit, nuk kanë të njëjtën energji dhe të njëjtën përballje të ngarkesës mësimore me 18 deri 20 orë në javë. Atëherë të shikohet një mundësi që edhe ky brez të jetë i integruar.

Ka probleme me investimet. Para 5 ditësh u organizua 50-vjetori i gjimnazit më me emër që ka Berati, “Babë Dudë Karbunara”, por sot ajo është godina më në emergjencë për t’u

investuar, kështu që gjej rastin ta transmetoj te ju shqetësimin, zonja Ministre, që në buxhetin e vitit 2019 rikonstruksioni i gjimnazit “Babë Dudë Karbunara” duhet të jetë një prioritet dhe në rast se nuk ka projekt nga Bashkia e Beratit, duhet të nxitet me hartimin e projekteve dhe pastaj me financimin përkatës të shkollave të tjera, që janë në akord me ato investime që justifikojnë praninë e nxënësve dhe përqendrimin e tyre.

Së fundi desha të di diçka në lidhje me policimin e shkollave, për të cilin kemi miratuar një ligj dhe i cili është shumë i dobishëm në garantimin e sigurisë së nxënësve në shkolla.

Edhe diçka tjetër, sa u përket psikologëve të specializuar keni bërë shumë mirë që keni ofruar një shërbim psikologu, por ato kanë një kriter që duhet të kenë 10-12 nxënës në zona të ndryshme. Por sipas mendimit tim, shërbimi i adresuar një herë në javë nuk sjell gjë. Do gjetur rruga ose mekanizmi i përqendrimit të tyre në institucione, sepse të shkosh një herë në javë dhe ta lësh nxënësin me aftësi ndryshe në të njëjtën klasë, ku janë të gjithë nxënësit e tjerë, kjo ishte një shëtitje e psikologut nga Berati në fshat. Kjo nuk funksionon.

Milva Ekonomi - Po, Ismet.

Ismeti Beqiraj - Pas kolegëve të mi, Fadilit dhe sidomos Bujarit, është e vështirë të flasësh, por unë përveç pyetjeve, do të bëj edhe disa komente lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor.

Milva Ekonomi - Ju lutem, do t’ju ndërpres pak.

Zonja Ministre, ju kohën për ne e keni deri në 10:45?

Lindita Nikolla - Jo, unë kam të gjithë kohën e duhur sot, për shkak se mbledhja e qeverisë është bërë dje, domethënë njoftimi ishte në 11 pa një çerek, me idenë se do të ishte sot mbledhja e qeverisë.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare e mbledhjes së radhës, të falënderoj për ndërhyrjen, sepse edhe unë isha i dyzuar në lidhje me kohën, në mënyrë që të na jepej mundësia t’i trajtonim pak më gjatë disa gjëra.

Në radhë të parë, ky fillim i vitit të ri shkollor është i mbarë. Më shumë se politikanët, më shumë se maxhoranca dhe opozita, këtë e ndjejnë nxënësit, e ndjejnë prindërit, kudo nëpër Shqipëri. Ky vit ka pasur një qasje më të përkushtuar nga të gjitha strukturat përgjegjëse për arsimin, sidomos për arsimin parauniversitar. Edhe unë, ashtu si kolegët e mi, ndonëse i kam të kursyera komplimentet, e komplimentoj me shpirt ministren dhe stafin e saj, që kanë arritur të përballen me sfidat e arsimit shqiptar në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë me ato të arsimit parauniversitar, në të gjitha aspektet. Është një lajm i mirë për të gjithë sot, ajo që tha qysh në

fillim ministrja, se kurrikula e re përfshin gjithë arsimin parauniversitar dhe në proces mbeten vetëm klasat e pesta. Ky është një hap shumë i madh drejt objektivit, ku ne synojmë të mbërrijmë.

Edhe dje, kur diskutuam për arsimin dhe formimin profesional, sigurisht që unë iu referova modelit të arritur nëpërmjet reformave të guximshme, risive dhe përpjekjeve të bëra nga Ministria e Arsimit, e Sporteve dhe Rinisë. Arsye tjetër është fakti se përballë këtyre nevojave, ministrja, jo thjesht nëpërmjet bashkëbisedimit e bashkëqeverisjes me qytetarët, e ka ndjekur me sytë e saj realitetin nëpër shkolla.

S’kam pse të mos shpreh në këtë takim të sotëm edhe një impresion që pata në fillim të këtij viti, kur ministrja e Arsimit erdhi në Mallakastër. Vajtëm në një shkollë, e cila në aspektin e infrastrukturës ishte për të qarë hallin, po kur pa atje një kolektiv shumë të përkushtuar, kur pa shpirtin e atyre mësuesve, e atyre mësueseve, e atyre drejtuesve dhe nxënësve, më erdhi mirë që mori si shembull qarkun e Fierit dhe tha: “Arsimin e bëjnë njerëzit, e bën vullneti dhe jo thjesht infrastruktura”.

Më erdhi mirë kur më bëri edhe mua një kompliment, duke më thënë: “Faleminderit, Ismet, që më ke kërkuar gjithnjë, sepse ne ndonjëherë, të ndodhur nën tryshninë e kërkesave në të gjithë Shqipërinë, edhe ju paragjykojmë”.

Unë pata fatin dhe kënaqësinë që këtë fillim viti, kur u bë hapja e shkollave, të shkoja në Mallakastër, jo vetëm me objektiva e premtime të mbajtura nga kjo maxhorancë, në lidhje me tekstet falas nga klasa e parë e deri në klasën e katërt, por edhe me një investim të konsiderueshëm të shkollës “Besëlidhja” në Ballsh, në shumën prej 75 milionë lekë të reja, e që pikërisht atë ditë koïncidoi të ishte edhe fillimi i investimit.

Nga ana tjetër, u përmendën shumë risi, por një nga risitë e tjera dhe në kontakt me gjithë personelin mësimdhënës, është se kur u mbyllën klasat kolektive, që sinqerisht kanë qenë një deformim në mësimdhënie në arsimin parauniversitar, nuk doli asnjë mësues për shkak të reformës. Përkundrazi, u sistemuan të gjithë në punë, kjo edhe për shkak të nismave për të bërë detyrat në klasë, edhe për mësuesit ndihmës, me qëllim që edhe Mallakastra, si e gjithë Shqipëria, t’i ndjejë këto produkte e këto risi të reformave të ndërmarra.

Megjithatë, e mira s’ka fund. Sigurisht, kur plotësohet një standard, do të kërkojmë të kalojmë te një standard tjetër. Kjo është dialektika e zhvillimit të jetës njerëzore.

Prandaj, në këtë fillim viti, përveç këtyre risive që përmenda më sipër, ne u ndeshëm edhe me disa probleme. Cilat janë këto probleme? Një problem i madh, ashtu sikurse me arsimin parashkollor, ishin kopshtet, që për shkak të kompetencave të dyzuara, hidhej topi sa te bashkitë te drejtoritë arsimore. Lidhur me transportin e nxënësve, unë u bashkohem

shqetësimeve që përmendën edhe dy kolegët e mi. Konkretisht, në Mallakastër ka një numër të konsiderueshëm nxënësish, të cilët transportohen. Nga 30 mijë nxënës në të gjithë republikën, gati 650 nxënës transportohen vetëm nga Zaja e Mallakastrës, rreth 107 mësues, dhe janë rreth 35 linja. Qysh në fillim, s'kam pse të mos e them sot këtë, nuk e patëm atë përkushtim dhe atë përgjegjësi nga organet e vetëqeverisjes lokale, pra nga bashkia Mallakastër. Dy ditët e para, më duhet ta them, drejtuesja e arsimit e ka financuar pothuajse vetë transportin e nxënësve në të gjitha linjat.

Kjo ka qenë edhe një nga arsyet, zonja Ministre, që kur kemi kaluar ndryshimet për ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar” nën për nen, kam kërkuar në këtë komision që kjo kompetencë të ndahet. Ne u kemi dhënë organeve të vetëqeverisjes vendore, bashkive, në ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar”, ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave të reja, u kemi dhënë të gjitha shërbimet, rojet e çdo gjë, por duhet t'u jepet edhe shërbimi i transportit të nxënësve, si një detyrim, meqë kanë marrë votën nga qytetarët. Le t'i bëjnë planifikimet e tyre, sepse nuk është ndonjë pjesë shumë të rëndësishme, që të mos u mbetet më si barrë ZAVE. Edhe tani që po flas, ekzistojnë tri linja, të cilat nuk janë miratuar nga bashkia, sepse linjat në Mallakastër i miraton bashkia.

Për koincidence e çudi, ka edhe ngjyrim politik, rreth 11 nxënës të fshatit të kryetarit të bashkisë hidhen në protestë për transportin, teksa ky ende nuk ka miratuar dhe certifikuar tri linja. Jo vetëm kaq, por përdoret edhe shprehja: “Qeveria mbylli klasat kolektive, qeveria të sigurojë transportin.” Sigurisht, por bashkia duhet të marrë përgjegjësi të plotë, gjë të cilën, unë si deputet, e kam shqetësim. Jo vetëm kaq, por do të kërkoja edhe ndryshimin ligjor, që t'ia japim atij që e ka tamam, që ta mbajë përgjegjësinë. Të mos merret vetëm me riqarkullim rrugësh dhe s'dihet se ku venë paratë e taksapaguesve shqiptarë e të qytetarëve, por të merret edhe me transportin e nxënësve e mësuesve.

Nga ana tjetër, një nga ankesat dhe ngërçet është se zona të tilla, si Mallakastra, por edhe zonat e vështira rurale, nuk janë si zonat urbane, të cilat janë të asfaltuara. Tarifa aktuale, sipas vendimit të qeverisë nr. 692, të 2015-ës, kur vetëm bileta vajtje – ardhje, pavarësisht distancës në kilometra, është 480 lekë të vjetra, mua më duket tarifë absurde për kërkesën dhe ofertën e tregut të sotëm.

Kjo ishte lidhur me shqetësimin për transportin, një shqetësim me të cilin jemi ndeshur realisht, që ditën kur filloi shkolla.

Jemi në prag të diskutimit të projektbuxhetit për vitin 2019. Do të sugjeroja të planifikoheshin më shumë fonde lidhur me materialet didaktike mësimore, e sidomos për

ngritjen, ringritjen dhe kompletimin laboratorëve, pasi kurrikula e re ka në bazë kompetencën. Ne duhet t'i paraprijmë kësaj, sepse nga inspektimet nëpër shkolla vërehen këto mangësi.

Në konceptin tim sfidat e ardhshme për arsimin do të jenë cilësia, standardi dhe komforti në të gjithë sistemin arsimor. Meqenëse po flas për zonën që përfaqësoj, edhe për shkak të bashkimit të shkollave që janë mbyllur, ndërkohë që në shkollën nëntëvjeçare “Gjokë Doçi” të Fratarit kanë shkuar edhe tri shkolla të tjera të asaj zone, konsideroj më emergjente një rikonstrukcion gjeneral, sepse shkolla po degradohet nga dita në ditë. Mund të jetë shumë e shpejtë dita kur edhe kjo shkollë të bëhet e pafrekuentueshme.

Unë si deputet, për shkak edhe të profesionit që kam, në fushën arsimore, mbështes e përkrah të gjitha nismat. Këto gjëra që na kanë mbetur, unë po i quaj si hajmali të këtij suksesi që ka arritur, por janë çështje shumë të domosdoshme dhe të nevojshme.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjalën e ka zoti Ulqini. Do t'ju lutesha që t'i përmblihdni shkurt pyetjet.

Musa Ulqini - Do të përpiqem të bëj një ushtrim, nëse është e mundur, unë që kam mbaruar shkencat politike të flas shumë shkurt, krahasuar me kolegët e mi, që kanë mbaruar shkencat ekzakte.

Zonja Ministre, ju drejtoni një sektor që ka një të mirë të madhe dhe një të keqe të madhe. E mira e madhe është se reformat që keni ndërmarrë, prekin si në asnjë sektor tjetër çdo familje: janë 400 mijë nxënës, që do të thotë se janë mijëra familje në Shqipëri në arsimin parauniversitar që i prekin me dorë reformat që përjeton arsimi.

Ndërkohë është edhe një sfidë për ju dhe një e keqe e madhe, sepse unë nuk kam njohur ndonjë sektor si arsimi, ku reformat e zhvilluara të kenë ngjallur dhe të kenë krijuar një aleancë kaq të madhe mes prapambetjes, regresit dhe fatkeqësisht opozitës.

Unë dua të sjell 3 shembuj, të cilat do t'i marr nga zona ku jam deputet.

E para, portali “Mësues për Shqipërinë” për të cilin ju nuk folët, sepse nuk kishit pse ta bënit këtë gjë, por është pa diskutim një reformë e jashtëzakonshme, që tashmë është pranuar dhe ka fituar të drejtën e qytetarisë kudo, edhe në Belsh ku unë jam deputet. Pse e sjell si shembull? Sepse, nga dhjetori i vitit 2014, kur u aplikua për herë të parë dhe deri sot, nuk është një kohë e gjatë, rezultati është vërtet mbresëlënës. Në një qark si Elbasani, ku për shkak të traditës së “Normales” numri i mësuesve në pritje është njëlloj si në kryeqytet, presioni për shkak të traditës shumë të keqe prej gati 25 vjetësh ndaj deputetëve për punën e emërimit të mësuesve ishte skandaloz.

Unë kam mbajtur një diskutim shumë emocional kohë më parë këtu dhe po ju them se kjo është një arritje e jashtëzakonshme. Si është e mundur që kjo çështje, që garanton cilësi reale, jo me fjalë, të anatemohet nga opozita? Nuk e kam kuptuar asnjëherë dhe nuk besoj se do ta kuptoj ndonjëherë!

E dyta, tekstet falas, 1800 nxënës me tekste falas. Zona e Belshit është një zonë që ka njerëz në nevojë, që janë kategori familjesh, të cilat kanë nevojë për mbështetjen e shtetit. Unë kam qenë vetë atje, e kam parë, e kam prekur me dorë këtë realitet. Si është e mundur që edhe për tekstet falas të dalë opozita, përfaqësues të opozitës në Elbasan dhe të mos jetë dakord, të gjejë edhe te kjo gjë kleçka, ta anatemojnë?! Unë nuk arrij ta kuptoj, por kjo është sfida e këtij sektori.

E fundit, klasat kolektive. Është një arritje e jashtëzakonshme. Unë isha vetë në Belsh, në një fshat që quhet Shtith, ku 11 nxënës ishin në klasën e 9-të. Familjet e tyre dolën dhe me një entuziazëm të madh i hipën fëmijët në furgon bashkë me mua dhe shkuan te shkolla 9-vjeçare në qendër të Belshit, një shkollë e madhe, e re, e rikonstruktuar, një shkollë me cilësi, të mësuesve, të mjediseve e të tjera. Si mundet tani që kjo gjë, që ju e shtjelluat shumë mirë të ketë një reagim kaq agresiv, kaq destruktiv dhe kaq regresiv?!

Në fund kam një pyetje: nuk e di se cili është opinioni juaj, do të desha një shpjegim të shkurtër, sesa pushteti vendor i ka kryer detyrat e veta lidhur me mirëmbajtjen e mjediseve të objekteve shkollore në të gjithë territorin në 60 bashkitë? Kryetarët e njohin ligjin, por jo të gjithë ata kanë një raport të njëjtë me të. A ka ndonjë shqetësim? Si e keni këtë marrëdhënie? Sepse kryetarët e bashkive, thonë: ligji, pavarësia e të tjera, por këtu duhet të jemi të gjithë bashkë dhe ju, si Ministri e Arsimit, keni informacion për këtë çështje, në mënyrë që edhe ne si përfaqësues të zonave që përfaqësojmë, të bëjmë presionin e duhur, pavarësisht se cilin përfaqëson kryetari i bashkisë; ai përfaqëson qytetarët të bëjnë detyrën për sa i përket mirëmbajtjes së shkollave.

Faleminderit!

Ju përgëzoj për informacionin që dhatë!

Milva Ekonomi - Faleminderit, zoti Ulqini, e mbajtët fjalën!

Po, zonja Bello.

Vilma Bello –Faleminderit!

Përsëritës zonjën Ministre, në radhë të parë, si edhe të gjithë stafin e Ministrisë së Arsimit, të cilët vazhdimisht kanë qenë pranë nesh për të gjitha informacionet! Por më së shumti do të doja t'i përsëritësja për të gjitha sfidat e fituara deri tani, për më tepër për sfidat që na duhet të realizojmë më vonë. Nëse ka nisma pozitive, të cilat kolegët i përmendën, unë

nuk do të doja t'u rikthehem, por thjesht do t'i prek. Ajo që ka të bëjë me dhënien e teksteve falas, si një nismë jo thjesht e mirë, por si një përfitim i drejtpërdrejtë në ekonominë e familjeve shqiptare. Nga ana tjetër, kurrikulat e reja, të cilat i japin dinjitet cilësisë së arsimit, ajo për të cilën kemi aq shumë nevojë.

Dua të përgëzoj edhe nismën e fundit, sipërmarrjen e fundit të shkollës së drejtorëve. Në informacionin që kemi përpara, kam disa sqarime të vogla. Aktualisht rezulton se në të gjitha institucionet arsimore është administruar ngarkesa mësimore e mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve. Administrimi i ngarkesës organizohet nga drejtuesit e institucioneve, duke u mbështetur në aktet normative të ministrisë për ngarkesën mësimore të punonjësve, numrin e nxënësve në klasë, bazuar edhe në udhëzimin nr.30. Pas daljes së këtij udhëzimi, a ka një informacion të saktë se sa mësues brenda sistemit nuk i plotësojnë ngarkesat e tyre? Kjo është një pyetje për të cilën do të doja një përgjigje.

Si deputete në Vlorë e dy prej zonave nga më të vështirat në këtë qytet, ditën e parë të fillimit të shkollës, kam shkuar në një shkollë të kësaj zone, zonave informale, e cila, për hir të së vërtetës, ka një infrastrukturë shumë të kënaqshme, është një shkollë e arsimit 9-vjeçar, shkolla "Ibrahim Kushta", infrastruktura e së cilës është mjaft e mirë dhe shumë pranë saj është edhe shkolla e mesme me të njëjtin emër. Ato që hasin vështirësi në qasjen e këtyre shkollave, që kanë një infrastrukturë shumë të mirë, janë zonat dhe rrugët për të shkuar në këto shkolla. Nëse infrastruktura në këto shkolla është e kënaqshme, rruga për të shkuar në këto shkolla është absolutisht jo e mirë. Kjo ka bërë që familjet e asaj zone, që janë në një numër jo të vogël, të harxhojnë para nga xhepat e tyre për t'i dërguar fëmijët në shkollat e tjera në largësi, pavarësisht se për të shkuar atje, kanë një rrugë shumë të shkurtër, as një kilometër, por është e pamundur për të kaluar. Dihet që është kompetencë e pushtetit vendor, por sa është e mundur të diktohet një komunikim bashkëpunues, që të mos i lëmë këto shkolla të pashfrytëzuara, sa kohë që kanë potencialin, numrin e nxënësve që banojnë në ato zona dhe infrastrukturën shumë më të mirë sesa shkollat e tjera që janë në qytet?

Nisma tjetër që është për t'u përshëndetur është ajo e 700 mësuesve ndihmës. Sa fëmijë me aftësi ndryshe studiojnë sot në arsim për të kuptuar se deri ku shkohet më mirë, që të jetë më shumë efikas numri i mësuesve ndihmës?

E fundit, duke përshëndetur përsëri nismën e shkollës së drejtorëve, do të doja të kuptoja pak më mirë atë që e thatë ju që do të jenë pjesë e kësaj shkolle drejtorash edhe drejtuesit aktualë të këtyre shkollave. Ajo që kemi arritur me portalin: "Mësues për Shqipërinë", është një nivel shumë i mirë i mësuesve që hyjnë në sistemin arsimor dhe i kanë dhënë dinjitet edhe cilësisë së mësimdhënies me fëmijët. Nga ana tjetër, nuk do të thosha të

njëjtën gjë për drejtuesit e shkollave, sepse ka mjaft drejtues të shkollave, të cilët nuk janë në nivelin e mësuesve. A duhet *a priori* që këta drejtues të shkollave, të marrin pjesë në shkollën e drejtorëve e më pas të licencohen dhe të mos mundën të lëvizin dot, sepse do të dalin nga një trajnim i tillë? Si do të jetë fasha e përcaktimit të atyre që do të marrin pjesë në këtë shkollë? Ka mjaft drejtues të shkollave, të cilët, në gjykimin tim, nuk duhet të jenë më drejtues.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, zonja Xhembulla.

Almira Xhembulla – Faleminderit!

Dua të falënderoj zonjën Ministre dhe stafin për të gjithë informacionin që paraqitën! Por ashtu siç u theksua edhe nga kolegët, ne kemi një marrëdhënie të vazhdueshme, kur bëhet fjalë për të zgjidhur apo për të marrë informacion për çështje të ndryshme që lidhen me zonat që ne përfaqësojmë. Është një komunikim i vazhdueshëm dhe në njëfarë mënyre ka funksionuar shumë mirë për të parë dhe për të përmirësuar punën në çdo zonë që përfaqësojmë.

Dua t'u përgëzoj, pasi edhe këtë vit në arsim vijmë me disa reforma shumë të rëndësishme, që u përshtaten shumë mirë objektivave jo vetëm kombëtarë, por edhe atyre ndërkombëtarë, siç janë objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit. Ne vijmë pas një diskutimi që u bë lidhur me këto, pikërisht objektivi nr.4 lidhet me ofrimin e një arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë nxënësit, duke mos lënë asnjëri mbrapa me idenë për ta siguruar këtë shërbim në çdo skaj të Republikës së Shqipërisë.

Nuk dua të përsëris ato që thanë kolegët, por duke qenë se përfaqësoj një ndër qarqet më problematike për sa i përket mungesës së infrastrukturës në përgjithësi, kemi ende problem. Doja t'ju falënderoj për mënyrën se si është menaxhuar procesi. Është një numër i madh shkollash dhe klasash kolektive, që u desh të mbyllen apo të qendërzohen në disa qendra në qarkun e Dibrës. Pati disa kontestime, nga kolegët tanë të opozitës, që, të them të drejtën, ishin të papranueshme, duke qenë se, e thashë dhe e ritheksoj, ofrimi i një arsimi cilësor për të gjithë nxënësit, kudo që janë, është një detyrë e përbashkët, por patjetër që duhet të koordinohet edhe me politikat që bën Ministria e Arsimit.

Kam një pyetje. Është një nismë shumë e mirë, por ndërkohë nuk e di, si është parashikuar në zonat ku mungon infrastruktura rrugore, pra ku është e pamundur ose e vështirë të funksionojë lëvizja me transport publik? Për shembull, gjatë stinës së dimrit ka raste kur është e vështirë lëvizja me mjete të transportit rrugor. Në këto raste, a janë marrë parasysh të gjitha këto, le të themi, probleme që janë aktualisht në disa zona? Ne patëm dy raste në shkollën e Rabdishtit, si dhe në një shkollë në Selishtë, që patën probleme në ditët e para të fillimit të

shkollës, por me një koordinim të mirë me përfaqësuesit e zonës dhe të drejtorisë arsimore, u zgjidh në kohë. Nuk e di nëse ka pasur një plan “b” në këto raste, kur infrastruktura nuk e siguron transportin. A është marrë parasysh ky kriter?

Ndërkohë, dua të theksoj që është shumë e rëndësishme dhe është parë pozitivisht sigurimi i mësuesve ndihmës. Isha prezent në ditën e parë të shkollës, kur iu dhanë certifikata disa fëmijëve me aftësi ndryshe, të cilët kishin arritur të ndjekin gjithë vitin akademik shkollor. Ndihesha jashtëzakonisht mirë kur shikoja që i gjithë kolektivi, por edhe prindërit, ishin bërë pjesë e një kooperimi të përbashkët dhe këtë dua ta theksoj, sepse në të gjitha shkollat që kemi qenë, të paktën në shkollat e qytetit dhe në disa zona përreth, kishte një ndërveprim dhe një bashkëpunim shumë të mirë, jo vetëm mes mësuesve dhe nxënësve, por edhe ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit. Shikoj që atyre u është dhënë një rol shumë aktiv, vendimmarrës, bashkëveprues, bashkëpunues. Ndoshta kjo u nxit edhe nga “Shkolla qendër komunitare”. Besoj se aty mori më shumë rol bordi i prindërve, por pashë që me të vërtetë është një gjë shumë e mirë, të cilën duhet ta promovojmë si pozitive.

Nuk dua të ndalem më tepër te mënyra se si punohet, qoftë edhe me shpërndarjen e mësuesve, duke qenë se jemi një zonë problematike dhe ka gjithmonë sfida, por i rëndësishëm është qëllimi pozitiv dhe i përbashkët për t’u ofruar një arsim cilësor të gjithë nxënësve kudo që janë.

Po e ndërpres këtu fjalën time.

Dua vetëm të bashkëpunojmë në këtë pjesë, me qëllim që, me aq mundësi sa kemi, t’u ofrohet një shërbim sa më i mirë të gjithë nxënësve dhe qytetarëve në zonat që përfaqësoj.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Edhe unë doja të shtroja 2-3 pyetje, përpara se t’jua jepnim fjalën sërish.

Në fakt, duke ndjekur nga afër të gjitha zhvillimet që ka marrë sektori i arsimit parauniversitar, do të bëj një pyetje, që të kemi një informacion të përgjithshëm. Sa ka qenë numri i mësuesve që kanë filluar punë nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, që nga fillimi kur është krijuar e deri sot?

Kemi dëgjuar që ju keni ndryshuar, gjithashtu, edhe vlerësimin e nxënësve. Në fakt, procesi i vlerësimit ka të bëjë me cilësinë në arsim. Mbase mund të më shpjegoni pak, edhe për prindërit që ju dëgjojnë sot, si po ndodh procesi i vlerësimit të nxënësit?

Pyetja tjetër lidhet me një funksion të ri që ka marrë Qendra e Shërbimeve Arsimore. Ju e lançuat si një program, që vjen nga bashkëpunimi me Fondin Amerikano-Shqiptar për Zhvillim dhe ka marrë disa funksione të reja. Do të ishte mirë sikur të na i përsërisnit edhe

njëherë këto funksione, për t'i bërë edhe publike, sepse unë besoj se Qendra e Shërbimeve Arsimore është një nga qendrat model në Ballkan, jo vetëm në Shqipëri.

Për buxhetin e vitit 2017, ju e dini që së shpejti ne kemi një dëgjese në Kuvend për buxhetin faktik. A mund të kemi një informacion se sa para janë harxhuar në pjesën e buxhetit për investime, për investimet kapitale dhe shpenzimet që janë bërë për mjete didaktike?

Një tjetër gjë që doja të shtoja, është iniciativa juaj për të komunikuar me grupet e interesit për planifikimin buxhetor për vitin 2019. A ka filluar ky proces konsultativ me grupet e interesit për buxhetin e vitit 2019? A ka rezultuar bashkëpunues deri tani? Projektbuxheti që po hartohet do të vijë së shpejti për dëgjese në Kuvend dhe me siguri do të ishte mirë të kishim një informacion paraprak për këtë.

Ju faleminderit shumë!

Fjala është për ju.

Edhe një herë, shumë faleminderit për gatishmërinë dhe profesionalizmin që tregoni!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Të nderuar deputetë, unë do t'i marr me radhë pyetjet, por po e filloj nga më kryesorja, me përgjegjësinë e deputetes, por, pa dyshim, edhe me përgjegjësinë e ministres së Arsimit.

Ju falënderoj shumë për gjithçka që thatë për kurrikulën e re, por më lejoni t'ju them edhe një herë që është një moment shumë i rëndësishëm kthese në sistemin tonë arsimor, edhe pse jam e bindur që rezultatet do të shikohen në vitet me pas!

Më lejoni t'ju citoj shumë shkurt një *memo*, një përmbledhje, të gjetjeve kryesore të rekomandimeve, shkëputur nga raporti final i konsulencës ndërkombëtare, për vlerësimin e kurrikulës në arsimin bazë, paraqitur ish-ministrit të Arsimit dhe Shkencës në janar të vitit 2011: “Kurrikulës për arsimin bazë i mungon një kohezion i qartë dhe koherent, si dhe një filozofi e tillë, pasi nuk ka një kornizë kurrikulare të shprehur qartë, që do ta rregullonte sistemin e kurrikulës në përgjithësi. Plani mësimor për arsimin bazë është nga më të ngarkuarit në Europë, pasi përmban një numër tmerrësisht të madh lëndësh. Kurrikula dhe programet e ndërtuara me të, janë qartësisht shumë të mbingarkuara, si pasojë përqendrohet gjithë kurrikula mbi informacionin dhe njohuritë teorike e akademike, në vend të njohurive procedurale dhe aftësive njohëse të mësimnxënjes, që janë të një rendi më të lartë dhe nevojiten për një shoqëri të dijes, në fushën e vlerave dhe qëndrimeve kryesore”.

Kjo i kishte munguar sistemit tonë arsimor. “Objektivat dhe përmbajtja e programeve janë përshtatur dobët me moshën e nxënësve dhe kapacitetet e tyre reale. Objektivat dhe përmbajtja e programeve nuk kanë një bashkëlidhje të thellë vertikale e horizontale dhe, në këtë mënyrë, mungon konsistenca dhe integrimi real ndërkurrikular i lëndëve. Kurrikula nuk

përmbush nevojat dhe interesat e vërteta të nxënësve, nga njëra anë, dhe ato të prindërve dhe shkollës, nga ana tjetër. Mungon, në kuptimin e plotë të fjalës, një qasje e diferencuar, e tillë që të ofrojë shanse të barabarta për të gjithë nxënësit.”

Për ta vijuar më tej këtë mbingarkesë të kurrikulës: “Shumica e teksteve janë të mbingarkuara. Tekstet janë tepër shkencore, me një gjuhë tipike akademike dhe me një numër zgjidhjesh pedagogjike, që janë shumë të vështira të kuptohen nga nxënësit. Kurrikula është zhvilluar copa-copa dhe jo si një e tërë, ku të gjitha pjesët duhen lidhur me të tjerat”.

Lexova vetëm pak, por raporti është voluminoz, duke lënë edhe rekomandimet që brenda vitit duhet të fillojë puna për hartimin e kornizës kurrikulare dhe për ndërhyrjet emergjente në sistemin arsimor, për të bërë të mundur koherencën dhe për të mundësuar një cilësi të re. Unë e lexova këtë për të thënë se falë Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe falë gjithë ekspertëve tanë vendas dhe të huaj, të cilët na kanë mbështetur në këtë proces, ne ia dolëm që në 4 vjet, duke përfshirë edhe këtë vit, pra vitin e 5-të, ta zgjidhim këtë problem, pra të kemi një kurrikul koherente për çdo fëmijë nga parashkollori nga 3-18 vjeç, e cila të jetë e lehtësuar nga mbingarkesa, të mos cilësohet më si e mbingarkuar dhe tjetra, që është shumë e rëndësishme, të ketë standardet me të cilat punohet sot në shkollat europiane, pra në shkollat cilësore. Kjo do të thotë që të mos kemi një vizion të shkollës për të mundësuar të nxënësit thjesht dhe vetëm ripërsëritjen e informacionit, jo thjesht dhe vetëm për të mbushur kokat e nxënësve me gjithfarë informacioni, por për të mundësuar për të gjithë ata qëndrime, aftësi, shprehje, vlera, pra se si ata t’i përdorin njohuritë dhe informacionin nesër për të zgjidhur problemet e jetës. Kjo është shumë e rëndësishme. Për këtë ne nuk jemi mjaftuar thjesht duke thënë se në bëmë të mundur që në sistemin tonë arsimor të kemi një kurrikul të re me standarde bashkëkohore, por kemi ftuar ekspertin e UNESCO-s, i cili në prill të vitit 2017 deklaroi me zë e figurë: “Do ta kemi përsëri këtë institucion të rëndësishëm, i cili vlerëson si një shembull ekselent të Shqipërisë mënyrën se si realizoi politikën kurrikulare në sistemin arsimor në këtë kohë.”. Madje, fton që Shqipëria të kthehet në një shembull për t’u ndjekur edhe nga vendet e tjera të rajonit, por ato do të flasin vetë dhe publiku do të gjykojë për gjithë këtë gjë. Detyra jonë nuk është endja pas vlerësimeve që bën ministrja, politika apo disa ekspertë të caktuar, por nga nevoja permanente që ministrja vetë, së pari, dhe të gjithë të tjerët kemi pasur për ta matur sa dhe si kjo reformë është vërtet e duhura, nëse e kemi futur në sistem në mënyrën e duhur dhe si po zbatohet nga shkollat. Ndaj, e përsëris që UNESCO tha se jeni në rrugën e duhur. Është reforma që ngrihet mbi parimet e shëndetshme të arsimit të qëndrueshëm, të gjitha parimet e arsimit 2030. Patjetër UNESCO la edhe një set rekomandimesh, mbi bazën e të cilave ne po punojmë, në mënyrë që zbatimi i saj të marrë në kohë të gjithë cilësinë e duhur.

Gjithashtu, ju bëj me dije se në ditët në vijim Ministria e Arsimit do të ketë edhe një raport nga një eksperte, mirëfilli, e mundësuar nga UNICEF-i, e cila ka theksuar se si po zbatohet kjo kurrikulë dhe se si ne po zbatojmë rekomandimet që na janë lënë nga UNESCO, duke vizituar shkolla, duke parë procesin e vlerësimit, duke bërë takime me mësuesit dhe, kur them takime me mësuesit dhe vizita shkollash, nuk e kam për këtu në Tiranë, por në zona të caktuara, sipas zgjedhjes personale të saj. Kjo është shumë e rëndësishme.

Një tjetër çështje që unë e kam ndarë me publikun, por përfitoj ta ndaj edhe një herë me ju, është fakti se ne mund të bënim investime në arsim, mund të kishim edhe një kurrikulë të standardeve bashkëkohore, mund të përmirësonim edhe cilësinë e teksteve, duke i lehtësuar dhe duke i sjellë në parametrat bashkëkohorë, por nëse në sistem ne do të injektonim mësues me cilës të dobët, mësues jashtë profilin ose pa arsimin e duhur, mësues që përzgjidheshin për shkak të korrupsionit, politikës e me radhë, absolutisht do të ishte miopi politike dhe çdo emër tjetër mund t'i vinim, por jo atë të cilësisë në sistemin arsimor. Është një hallkë për të cilën ne na duhet ende shumë punë, shumë përkushtim dhe shumë vëmendje, që lidhet me cilësinë e mësuesve.

Portali “Mësues për Shqipërinë”, për të cilin gjej rastin t’ju falënderoj për gjithçka që thatë, sigurisht ishte një mundësi për ta larguar politikën dhe korrupsionin nga emërimet në arsim. Por më lejoni t’ju tregoj se ajo që në fakt ka bërë portali “Mësues për Shqipërinë” është një gjë krejt tjetër, se nga moria e diplomave gjithfarëshe të fakulteteve të edukimit që përgatiste mësues, të parët që u drejtohen shkollave janë mësuesit më cilësorë, janë mësuesit që zgjidhen nëpërmjet një testimi. Pra, portali “Mësues për Shqipërinë” ka rritur cilësinë e mësuesve në shkolla.

Sot drejtues, ekspertë të Institutit të Zhvillimit të Arsimit, unë vetë, sa herë i takoj, më rezultojnë se janë mësuesit që performojnë më mirë në shkollë.

Moment tjetër shumë i rëndësishëm që vlen të përmendet, dhe unë po jua them shifërën, sot në sistem janë 5000 mësues falë portalit “Mësues për Shqipërinë” që kur ka filluar në vitin 2014, është se ky portal është perfeksionuar, sepse tashmë testimet nuk zhvillohen në territor, por bëhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Pra, është edhe një shërbim i ri që e ofron kjo qendër, testimin online dhe të qendëruar të mësuesve, ashtu sikurse edhe procesi i rekrutimit të tyre nuk do të ketë asnjë kontakt tjetër, përpos njoftimit që do t’u bëhet në adresën e tyre nga portali. Kjo është shumë e rëndësishme, por nuk mjafton, sepse ne bëjmë edhe një matje tjetër. Kemi parë që programeve të mësuesisë u drejtohen nxënësit apo maturantët me nivelin më të ulët. Pra, ishte zgjedhja e fundit dhe e maturantëve më të dobët për t’u bërë mësues, gjë që më pas reflektonte në cilësinë e provimit të licencimit.

Ishte e pakuptueshme dhe patjetër një refleksion i plotë nga ana jonë kur shikonim që, edhe pse kishin shpenzuar pesë vjet shkollim, tre vjet *Bachelor* dhe dy vjet master, në programet e licencimit niveli i kalueshmërisë nuk arrinte as 40%, për të mos folur për cilësinë e dobët të mësuesve. Kjo gjë na bëri të nisim një reformë tërësore në sistemin e mësuesisë dhe mendoj se këtë vit ajo do të japë efektet e saj, sepse qeveria e nisi me vendosjen e një note mesatare në të gjitha programet e mësuesisë, që është nota 7, si dhe duke incentivuar që jo për këdo që zgjedh mësuesinë, por për të gjithë nxënësit ekselentë, me mesatare të lartë, të cilët zgjedhin programet e mësuesisë, ua mbulon shteti tarifën e shkollimit.

Tjetër moment që dua ta përmend është fakti që, sikur të mos mungonin formimi i dobët, maturantët më të dobët që shkonin në programet e mësuesisë, sistemi *part-time*, që e dimë shumë mirë se si ishte dhe që u mbyll, universitetet e mbyllura, të cilat, gjithashtu, ofronin programe në mësuesi, kishim edhe një sistem tjetër për kualifikimin në vijim të mësuesve, që ishte një sistem nga “A”-ja te “Zh”-ja i kapur nga korrupsioni, që nuk mundësoi asnjëherë një standard minimal informimi se ku është niveli i mësuesve shqiptarë. Mjaftonte një telefonatë dhe ti merrje kreditet e kualifikimit, por nuk ishte vetëm kjo. Ishte qasja që profesorët e nderuar, të cilët ishin në krye të Ministrisë së Arsimit, e konceptonin sistemin thjesht dhe vetëm si një mjet, që mësuesi të merrte kualifikimin pesëvjeçar, dhjetëvjeçar e kështu me radhë. Ndërkohë, qasja jonë është krejt tjetër. Patjetër që mësuesi duhet të bëjë përpara në karrierën e tij, por ne do ta matim se si trajnimet, nëpërmjet sistemit të ri të kualifikimit, përkthehen në atë që është arritja e nxënësve. Pra, çfarë ndodh pasi një mësues merr një proces kualifikimi, i monitoruar, i standardizuar, i cilësisë më të mirë, me çmime të unifikuara, me një portal të dedikuar kur ai kthehet në shkollë? Sa dhe si ky trajnim nuk shërben thjesht dhe vetëm për mësuesin, që kur të testohet nga IZHA të marrë provimin, por si përkthehet në cilësi dhe arritje? Ky është besoj edhe një moment tjetër shumë i rëndësishëm.

Për të ardhur te shkolla e drejtorëve, dhe besoj u jap përgjigje pyetjeve, shkolla e drejtorëve nuk është institucion, që do të futen këta drejtorë, do të dalin dhe do të certifikohen, se nuk është fare kjo arsyeja pse unë, kjo qeveri apo Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim po investojmë miliona dollarë.

Nëse ne duam të mbajmë për drejtorë të shkollave këta që janë dhe ata që ndoshta do të vijnë me këtë sistem, nuk na pengon askush. Ishte ligji.

Pikërisht se ne duam t’i themi të paaftit: “Ti je i paaftë!”, por këtë nuk e mat as politika, as ministri, as drejtori i Drejtorisë Arsimore, por një institucion, ku do të ketë provim aty dhe këta njerëz që futen tek ajo shkolla, patjetër do të zmbarsen. Edhe pse ti dhe këta drejtorët që sot janë të paaftë e kanë masterin e fakultetit, për të cilin shqetësohet eksperti i opozitës, madje

kanë një sërë diplomash, por nuk kanë aftësinë e duhur për të performuar në shkollë. Kjo shkollë drejtorësh këtë do të masë, por një herë do të mundësojë standardet më të mira, sepse Shqipërisë i mungojnë.

Ne sot nuk kemi një dokument ose Instituti i Zhvillimit të Arsimit nuk ka një dokument, publiku shqiptar nuk ka një dokument, që të masë performancën e drejtorëve, të vlerësojë se çfarë po bëjnë drejtorët e shkollave. Kjo është një mangësi për ata vetë njëherë, që janë të lënë vetëm në mëshirën personale të vullnetit të tyre apo të aftësive të tyre, por të pambështetur me cilësinë e standardeve më të mira, për të bërë të mundur një menaxhim efikas dhe përmirësimin e jetës shkollore.

Një dokument që kemi ne, standard i drejtorëve, që rrek të vlerësojë performancën, e ka të pamundur, kështu thonë ekspertët, nuk tregon as metodologjinë dhe nuk është bërë dot i mundur një mjet për të matur dhe për të vlerësuar drejtorët e shkollave. Ndaj, ne po ngremë njëherë një sistem, po sjellim në Shqipëri një shkollë për të thënë se cili është niveli i qëndrimeve, i shprehive, i aftësive dhe i njohurive që duhet të kesh për të qenë një drejtues shkolle.

Më pas, ti do të kalosh në një testim, në një provim të vështirë, që të sigurosh publikun se, po, Lindita Nikolla e mori këtë provim dhe është e certifikuar për të qenë e aftë për të drejtuar një shkollë. Kjo jo vetëm do të nxjerrë jashtë edhe ata që ne na duken të aftë për shkak të malit të diplomave që kemi, por, nga ana tjetër, do të mundësojë që nesër një ministër tjetër i Arsimit të mos zgjedhë askund tjetër, përpos bashkësisë së këtyre njerëzve që kalojnë nga shkolla e drejtorëve. Madje them se ne patjetër kemi matjen tonë se si do ta bëjmë me fashat, me moshat, me performancën e tyre, me të gjitha vlerësimet paraprake që ne kemi, por, nga ana tjetër, shkolla e drejtorëve është një ftesë për të gjithë ata të rinj dhe të reja të talentuar dhe jo vetëm, të cilët aspirojnë të jenë në drejtimin e shkollave, që të parapërgatiten dhe ta marrin këtë certifikatë, në mënyrë që prindërit, nxënësit dhe shoqëria të mos humbasë nesër kur një tjetër ministër vjen në krye të Ministrisë së Arsimit, për të bërë sërish historinë e vjetër të përzgjedhjes pa cilësi. Do të zgjedhë, sepse, falë jush dhe falë votës së deputetëve të maxhorancës në parlament, kjo është standardizuar tashmë në ligj dhe duhet të zgjedhë vetëm nga kjo bashkësi. Ky është thelbi, jo se ne do të çojmë këta drejtorët, i çove në shkollë dhe do të dalin nga kjo shkolla. Kjo është shkolla për t'u thënë: "Ik!" jo të paaftëve që i kemi vlerësuar ne dhe, patjetër, që nuk do t'i drejtohen kësaj shkolle, por edhe atyre të aftëve të fshehur në malin e certifikatave pa asnjë lloj vlere, në kuptimin e aftësive personale. Patjetër, madje e përsëris, do të vijë momenti i ndarjes njëherë e përgjithmonë nga politika, nepotizmi, pasi ti do të kërkosh nga njerëzit që janë të certifikuar nga shkolla e drejtorëve.

Çështja tjetër së cilës dua t'i rikthehem, pasi doli edhe në pyetjet tuaja, është ajo e transportit. Është shumë e vërtetë që zgjidhja e kësaj çështjeje është problem. Kjo çështje nuk është thjesht dhe vetëm çështje kalimi kompetence nga ne te bashkitë. Ne ua kaluam bashkive. Në vitin 2016-2017 ishte kompetencë e bashkive. Dështuan me sukses, sepse nuk e panë këtë si një mundësi për të përmirësuar shërbimin, pra një buxheti, që vinte nga qeveria t'i adresoj edhe një buxhet vendor, për t'i maksimalizuar këto buxhete dhe për të përmirësuar shërbimin, por e panë thjesht dhe vetëm si ca buxhete më shumë dhe kërkuan rikthimin pas në drejtoritë arsimore, pra në sektorin e arsimit. Dështoi.

Është absolutisht e vërtetë që tenderi dështon në disa zona, sepse për shkak të rrugëve të vështira nuk marrin përsipër që për një numër të vogël nxënësish, të ofrojnë shërbimin e transportit. Në këto raste drejtoritë arsimore kanë operuar, duke bërë pagesën dhe unë nuk besoj që shkollës t'i shkojë pagesa dhe ajo nuk ua jep prindërve, por pagesa u çohet prindërve apo mësuesve.

Sigurisht, nuk është kjo ajo që duam dhe qëllimi për ta adresuar këtë shërbim. Për sa na takon ne, kemi zhvilluar 2 tryeza me pushtetin vendor, madje duke u deklaruar se nëse ata nuk bëjnë të mundur jo vetëm shërbimin e transportit, por edhe parapritjen e investimeve në shkolla lidhur edhe me projektin e përqendrimit dhe të zvogëlimit të klasave kolektive, do të marrin një minus në vlerësimin e projekteve shkollore. Edhe kjo nuk ka mjaftuar që ato të ndërgjegjësohen dhe të vijnë në nivelin e përgjegjësisë për ta zgjidhur këtë problem. Tarifat janë të vitit 2006 dhe indeksohen çdo vit, por besoj se ky është një problem, që ne do ta adresojmë sërish. Ndaj Kryeministri Rama ka caktuar nën përgjegjësinë time, të ministrit të Transporteve dhe, besoj, edhe të ministrit të Financës dhe Ekonomisë, ngritjen e një grupi të përbashkët, që ne t'i paraprijmë në kohë të gjitha ndryshmeve të nevojshme për çfarë duhet të bëjmë, ndoshta duke adresuar një moment për pushtetin vendor, për mënyrën se si do të operohet në vitet në vijim. Po ashtu, edhe për rritjen e tarifave dhe për mundësi të tjera në lidhje me të gjithë operatorët që ofrojnë shërbimin për transportin e mësuesve dhe të nxënësve të sistemit arsimor.

Një tjetër çështje që dua të them, lidhet me laboratorët, me fondet për to. Janë rreth 100 milionë lekë, që adresohen pikërisht për laboratorët didaktikë. Përgjithësisht, në të gjitha shkollat, ku bëjmë rikonstruksione dhe ndërhyrje, i shoqërojmë me pajisjen me mjete mësimore dhe me laboratorë. Patjetër, marrim kërkesat që vijnë nga DAR-et dhe nga shkollat. Ky është një moment kur ne po e shohim për të adresuar kërkesat në mënyrën më të mirë të mundshme, por duhet thënë se në këto vite ky buxhet ka pasur një rritje dhe një impakt krejt tjetër në punën e mësuesve në shkolla.

Për sa i takon asaj që ju thatë për mësuesit në prag të pensionit, është një ide shumë e mirë dhe unë, duke ruajtur autorësinë e deputetëve të këtij komisioni shumë të nderuar, po ju them se do të ngremë një grup pune për të mundësuar jo daljen në pension apo uljen e normës, por atë që është shumë e rëndësishme dhe që bota e njeh si një praktikë të mirë, procesin e mentorimit të mësuesve të rinj nga këta mësues. Besoj se një lajm i ri në sistemin arsimor do të jetë adresimi i kësaj çështjeje dhe unë ju falënderoj, që e sollët këtë në vëmendjen tonë!

Për sa i takon pyetjes tjetër, se sa i ka realizuar detyrat pushteti vendor, më lejoni që të mos përgjigjem sot në mënyrë shteruese, se të jem e sinqertë, nuk e kam bërë këtë matje, por di që ka shumë kryetarë bashkish, që koordinojnë dhe bashkëpunojnë, pa dallim të majtë apo të djathtë, por ka dhe shumë syresh që e shikojnë çështjen e arsimit si një apendiks në të gjithë veprimtarinë e tyre, sepse realisht në atë që ne dorëzuar në materialet tona për të 12 qarqet, apo për çdo kryebashkiak për procesin e përqendrimit të shkollave, ishte në fakt një e mirë për ta, sepse ata miradministronin buxhetet nga përqendrimi i shkollave dhe përfitonin nga Ministria e Arsimit më shumë investime në shkollat, ku do të përqendroheshin këto. Nuk është kuptuar si e tillë ende nga të gjithë, por besoj se ne do të punojmë edhe në ditët në vijim, duke u lënë një set rekomandimesh se çfarë do të bëjmë vitin e ardhshëm, që ata të adresojnë edhe nga pikëpamja e infrastrukturës rrugore, në zonat, ku është i vështirë transporti e kështu me radhë.

Ky është një moment që kërkon shumë ndërgjegjësim dhe siguri, unë nuk dua të paragjykoj askënd, kërkon kurajë dhe guxim për t'u ngritur në lartësinë e përgjegjëseve, sepse arsyet për t'u ndalur dhe për të mos folur fare për klasat kolektive janë të shumta, por besoj se secili prej atyre vogëlushëve apo nxënësve që mësojnë në ato shkolla, është një arsye e fortë që ne të jemi të gjithë bashkë, pa parë ngjyrat politike dhe partiake.

Për sa na takon ne, unë ju garantoj se tryeza do të vijojë me kryetarët e 61 bashkive, për të treguar në secilin territor se sa dhe si ne duhet ta ndryshojmë situatën e mësimin në klasat kolektive, por jo vetëm.

Pyetje tjetër së cilës dua t'i përgjigjem është: pas daljes së udhëzimit, sa mësues nuk i plotësojnë ngarkesat e tyre?

Është në proces, sepse edhe ligji parashikon që deri në fund të tetorit ka shkolla që punojnë me ndarjet e klasave dhe me regjistrimet, pra numri që ju thashë sot, është një numër që do të finalizohet në nëntor dhe do të kemi realisht numrin e plotë të nxënësve që kemi në sistemin arsimor dhe se si kanë punuar shkollat për sistemimin e mësuesve. Ndërkohë, unë po e përsëris, se projekti i bërjes së detyrave të shtëpisë në shkollë, do të jetë një projekt që

do të mundësojë që mësuesit, që nuk i plotësojnë orët e tyre mësimore apo që dalin nga sistemi për shkak të uljes së orëve mësimore, do të mbeten në sistem edhe në kuadër të këtij programi.

Programi i bërjes së detyrave të shtëpisë, nuk do një mësues që sillet në klasë e në shkollë, teksa nxënësit përgatiten, por është mirëfilli një metodist, një mësimdhënës. Ndërveprimi dhe qasja krejt e ndryshme, mundëson edhe procesin e bërjes së detyrave të shtëpisë, si një proces interaktiv nxënieje dhe edukimi për këta nxënës. Kështu ne e kemi shprehur vullnetin dhe po ecim hap pas hapi, pa u shmangur jo vetëm nga vullneti, por edhe nga parimi që mësuesit që janë në sistem, të mos t'i nxjerrim jashtë sistemit.

Tjetër gjë që dua të them, është përgjigja e pyetjes si do të veprohet aty ku mungon rruga. Unë e thashë edhe në fillim se do të ishte një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët, nëse do të kishim mundur t'i mbyllnim të gjitha klasat kolektive. Kjo është e pamundur dhe do të jetë e tillë edhe në vitet në vijim, sepse klasa kolektive ka edhe në Francë, edhe në Portugali, edhe në Zvicër, në zonat e thella, ku është e pamundur t'i transportosh fëmijët e vegjël, por ne po bëjmë një gjë tjetër: ne nuk jemi dorëzuar dhe po trajnojmë fort mësuesit e klasave kolektive, dhe kemi një metodologji të re trajnimit dhe të punës në këto klasa.

Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara apo me aftësi ndryshe? Janë 3700 fëmijë të tillë, por jo të gjithë janë fëmijë që kanë të nevojshëm mësuesin ndihmës. Ata që e kanë të nevojshëm mësuesin ndihmës, kjo përcaktohet nga komisioni psikosocial, që ndërtohet pranë çdo drejtorie dhe zyre arsimore, janë 1944 fëmijë, ndaj ne jemi të angazhuar, që hap pas hapi të rrisim cilësinë e mësuesit ndihmës, duke mundësuar që deri në fund të mandatit çdo fëmijë, që vlerësohet nga komisioni përkatës multidisiplinar, si një fëmijë që ka të nevojshëm mësuesin ndihmës, ne ta bëjmë të mundur praninë e tij.

Nga portali, siç e thashë, janë rreth 5000 mësues në këto vite dhe ky është një proces që vijon, sepse ndryshon çdo ditë. Buxheti faktik i vitit 2017 janë 39 miliardë e 450 milionë lekë. Unë do ta sqaroj edhe në parlament, se ditën e enjte kemi seancën ku do të jap të gjitha detajet si është shpenzuar, cilat janë fushat ku ky buxhet është shpenzuar dhe sa dhe si ky buxhet ka shërbyer për një cilësi të re në sistemin tonë arsimor.

Ndërkohë, më lejoni t'ju them se, për sa i takon buxhetit të vitit 2019, kemi bërë disa konsultime me shoqërinë civile për fazën e parë të hartimit, ku kemi marrë në konsideratë shumë prej kërkesave të saj për mësues ndihmës, për përmirësimin e shërbimit psikosocial në shkollë, investime e të tjera. Është një proces që vijon dhe rezulton shumë efficient, sa herë që ne organizojmë dhe adresojmë tryeza të tilla komunikimi për investime në arsim.

Gjithashtu, dua të jap përgjigje edhe për programin e oficerëve të sigurisë në shkollë. Këshilli i Ministrave dje mori vendim që nga 15 oficerë sigurie që kishim, vetëm në 15

gjimnaze të Tiranës, ky program të shtrihet në 150 shkolla të mesme. Kjo nismë ka pasur sukses gjatë pilotimit, prandaj do të vendosim 150 oficerë sigurie në shkolla. Vetëm në dhjetë javë ata kanë shërbyer për zgjidhjen e 80 rasteve të konfliktit që vinin nga duhani, alkooli apo lëndët narkotike. Janë parë si instrument shumë i rëndësishëm në procesin e edukimit nga komuniteti i mësuesve, prindërve, por edhe nxënësve. Këtë përvojë ne do ta shtrijmë në 150 gjimnaze në të gjithë vendin, prandaj qeveria vuri në dispozicion buxhet, në mënyrë që kjo të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Profili i oficerëve të sigurisë janë djem dhe vajza të shkolluar në mësuesi, sociologji, psikologji, por ne po bashkëpunojmë edhe me Ministrinë e Brendshme, sepse ata duhet të kalojnë edhe trajnimin pranë Akademisë së Sigurisë, në mënyrë që të marrin edhe kompetencën për procesin e parandalimit, zgjidhjes së konflikteve, por edhe një ndërlidhje me komisaritet e policisë për atë që quhet rrethi i dytë apo i tretë i shkollës.

Për sa i përket pyetjes për Qendrën e Shërbimeve Arsimore, pas riorganizimit të strukturës së ekzekutivit, Ministria e Arsimit nuk ofron më shërbime për qytetarët. Është një institucion politikëbërës dhe monitorues për zbatimin e politikave. Të gjitha shërbimet që deri dje ofroheshin nga Ministria e Arsimit, si: njohja e diplomave, vërtetimi i vërtetësisë së dëftesave të ndryshme dhe, padyshim, asaj që është prioriteti ynë, gjithë procesi i certifikimit të testimit për profesionet e licencuara, monitorimit të maturës shtetërore, testimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, testimi i mjekëve që kalojnë në specializim e kështu me radhë, i kanë kaluar Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Qendra e Shërbimeve Arsimore duhet përshëndetur që, edhe në kushte infrastrukturore jo si këto që qeveria i ka krijuar, edhe më parë ka ofruar shërbime cilësore me zero korrupsion. Është qendra që i ka kthyer dinjitetin jo vetëm provimeve të shtetit, por edhe procesit të specializimeve në mjekësi, sepse pikërisht kjo qendër ka monitoruar të gjithë testimin e mjekëve që kërkojnë të jenë kandidatë për t’u specializuar në fusha të ndryshme në sektorin e shëndetësisë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, zonja Nikolla!

Kolegë, jeni të sqaruar për të gjitha pyetjet që bëtë?

Bujar, mund të falënderojmë të gjithë ekipin e ministrisë për shpjegimin e mirë që bënë?

(Bujar Çela flet pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Mund të bëj edhe unë një falënderim?

Unë e kuptoj dashamirësinë që buron prej njerëzve të një skuadre dhe një ideali, por më lejon t'ju them se jam ndier si kurrë ndonjëherë, jo për qetësinë për të folur dhe dëgjuar, por për mënyrën se si njerëz qytetarë dhe të përgjegjshëm më kanë motivuar për të ndier peshën e atyre që them. Në situata të tjera, kur duhet të organizosh instrumente të tjera për të pasur mbrojtje përballë të pavërtetave dhe egërsisë, më është dashur të aktivizoj të gjithë forcën e arsyes, mendjes, por edhe të zemrës për t'u përgjigjur me përgjegjësi nga ky pozicion. Kështu që, ju falënderoj shumë!

Milva Ekonomi – Ne ju premtojmë që do t'ju qëndrojmë pranë në çdo nismë që do të ndërmarrë Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

Meqenëse e quajmë detyrën tonë të rëndësishme për të bërë edhe kontroll parlamentar, ne kemi marrë përsipër që në ditët në vijim të bëjmë disa takime me agjencitë tuaja të varësisë. Për shembull, meqenëse jemi në prag të fillimit të vitit të ri akademik, për ne do të ishte me shumë vlerë të bënim një takim me Agjencinë e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Do të vazhdojmë të kontaktojmë me të tjera institucione të varësisë suaj, duke ju njoftuar edhe ju për çdo veprim që do të ndërmarrim, por kemi nevojë për ju që t'i mundësoni këtij komisioni që disa aktivitete t'i zhvillojë në terren. Për shembull, së bashku të zhvillojmë një vizitë në një shkollë ku ka pasur klasa kolektive dhe ato janë mbyllur. Duke pasur parasysh që duam të jemi afër dhe të shikojmë se si implementohen në terren reformat, kemi nevojë edhe për ndonjë sugjerim tuajin për ato që mendoni se janë vende që kanë nevojë edhe për ndihmën tonë, por kanë nevojë edhe për të bërë një lloj ndërgjegjësimi për atë që po ndodh.

Lindita Nikolla – Faleminderit për këta komponentë të rëndësishëm! Për mua është shumë i shtrenjtë ky monitorim që ju bëni.

Në datën 15 kemi takimin e parë me rrjetin profesional të të gjithë mësuesve që punojnë në klasa kolektive, kështu që, përfitoj nga rasti t'ju ftoj edhe ju.

Mund ta rakordojmë ditën në varësi të axhendës suaj, në mënyrë që të shikoni se çfarë ka ndryshuar realisht në mënyrën si e perceptojnë ata, si punonin më parë, sepse janë të njëjtët mësues dhe cilat janë mundësitë e reja që ofron procesi i trajnimit dhe e gjithë paketa që ju vjen në ndihmë, që ata, edhe pse do të vijojnë të punojnë në klasa kolektive, të kenë një vlerë të shtuar në mënyrën se si performojnë në këto klasa. Patjetër, do të bëjmë një kalendar të plotë edhe për vizitat në shkolla.

Unë ju sugjeroj të zhvilloni një takim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, sepse shpeshherë flet ministri për reformat në sistemin e arsimit parauniversitar, por, në fakt, truri i reformës në sistemin e arsimit parauniversitar ka qenë ai institucion. Gjej rastin të falënderoj drejtorin, por edhe të gjithë stafin. Është një staf që e kam gjetur, kështu që ministrja nuk ka

asnjë lloj merite në këtë aspekt. Janë njerëz të përkushtuar, të cilët do t'ju thonë vetë si janë ndier këto 4 vjet, jo vetëm në intensitetin e punës, por edhe në mënyrën si janë dëgjuar, si kanë marrë vendime dhe se si, më pas, vendimmarrja ka qenë bazuar në ekspertizën e tyre. Patjetër edhe kritikën, që jemi lodhur dhe kemi punuar shumë, por në fund fare ia ka vlejtur, sepse besoj se reforma ka sjellë dhe do të sjellë ndryshime. Pas indicieve të para që kanë ardhur tek unë për investigimin e arsimit, të cilat do t'i ruaj derisa të bëhen publike, besoj se do të kemi lajme të mira. Besoj se edhe nga *PISA* 2018 do të kemi lajme të mira dhe progres, por do t'i shikojmë hap pas hapi.

Ju faleminderit edhe njëherë.

(Znj. Ministre largohet.)

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2018 ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i programit të punës së komisionit për muajon tetor 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Fatmir Velaj, Bujar Çela, Almira Xhembulla dhe Besnik Baraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj dhe Adelina Rista.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Do t'ju marr vetëm dy minuta kohë.

Ne kemi bërë kalendarin e punës për muajin shtator, ndërkohë duhet të bëjmë kalendarin e punës për muajin tetor për ngjarjet që vendosëm të ndjekim nga afër.

Kemi një projektvendim, që ka ardhur me një nismë deputeti, për përdorimin e alkoolit nga të miturit. Unë bisedova me nënkryetaren e Komisionit të Çështjeve Sociale, por ajo nuk do të jetë këtu javën tjetër, kështu që mendoj ta vazhdojmë vetë, për të mos e penguar punën.

Unë mendoj që të hënën e ardhshme të bëjmë dëgjuesën për projektligjin për përdorimin e alkoolit nga të miturit.

Të martën kemi një dëgjuesë me OJF-në që drejtohet nga Altin Hazizaj lidhur me dhunën që ushtrohet te fëmijët e moshës së arsimit parauniversitar. Kjo OJF ka bërë edhe një raport lidhur me dhunën ndaj fëmijëve.

Kisha planifikuar, me qenë se fillon dhe viti i ri akademik, një vizitë në institucionin e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, po mbase mund ta ndryshojmë dhe mund të shkojmë te Instituti i Zhvillimit të Arsimit, me rekomandimin që bëri ministrja.

Javën që vjen, unë mendoj ta nisim me një dëgjuesë me Inspektoratin e Punës lidhur me situatën në fushën e gazetarisë dhe të kontratave të punës që kanë gazetarët. Të martën dhe të mërkurën t'i dedikohemi pak kulturës dhe mendoj të bëjmë një vizitë në Muzeun Kombëtar dhe një vizitë në Apoloni; ta organizojmë vetë me ndihmën e Bujarit dhe të Adelinës, që kanë qenë të gatshëm të na ndihmojnë për këtë gjë, për të parë se çfarë ka sjellë ligji i ri i trashëgimisë kulturore për to dhe çfarë kanë sjellë investimet e reja lidhur me numrin e rritur të vizitorëve dhe menaxhimit më të mirë që i është bërë *sajt*-it.

Këto takime kam parashikuar unë deri në nëntor. Duke folur dje me Arianën lidhur me dëgjuesat që ne kemi bërë për projektbuxhetin e vitit 2018, vure re se kemi harxhuar 8 seanca për dëgjuesat dhe për diskutim të projektligjit, pastaj ka ardhur diskutimi që kemi bërë nen për nen dhe në lidhje me objektivat që kemi kundrejt programit qeverisës.

Pra, muaji nëntor besoj se do të jetë një muaj më tepër i dedikuar për dëgjuesat, që kanë të bëjnë me projektbuxhetin.

Prandaj të presim të vijë projektbuxheti dhe të bëjmë planifikimin për muajin nëntor. A jeni dakord me këto aktivitete?

Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Duke qenë se në fillim të javës që vjen fillojnë mësimin institucionet e arsimit të lartë, pasi kanë mbaruar fazat e konkurrimit dhe regjistrimit, pasi kemi dëgjuar në intervistat e ndryshme të drejtuesve të këtyre institucioneve, se janë mbyllur disa degë, unë them se ia vlen të bëjmë një dëgjuesë lidhur me fillimin e arsimit të lartë, qoftë në aspektin e procesit të regjistrimit, qoftë në aspektin e degëve që kanë pasur probleme me cilësinë, meqenëse edhe neve na intereson në disa aspekte. Njëri aspekt është se qeveria këtë vit rriti notën mesatare për arsimimin, një tjetër për programet që përgatisin mësues për shkollat parauniversitare, prandaj ia vlen të bëjmë një dëgjuesë për të parë edhe interesin e studentëve që kanë konkurruar.

Milva Ekonomi – Unë të falënderoj që na e solle në vëmendje, sepse edhe vjet kemi bërë të njëjtën gjë, kemi thirrur ministren në një dëgjesë pas fillimi të vitit të ri akademik.

Unë mendoj se mund të bëjmë një dëgjesë në datën 3 nëntor. E vendosim tani në kalendar.

Musa Ulqini – Vizitën në Bylis ne do ta bëjmë pas datës 3 nëntor.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Shkruani të gjithë propozimet që keni për kalendarin!

Ju faleminderit shumë!

Keni marrë një e-mail ku është rendi i ditës për nesër.

Ditën e mirë.

MBYLLET MBLEDHJA

